



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 455 Prot

Tiranë më, 02.05.2023

Nr. 1854 Dosje

U R D H Ë R

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaaruesit Gjyqësor, në referim të Vendimit Nr. 306 (945) Vendimi, të lëshuar me datë 24.04.2019 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, ndryshuar me Vendimin Nr. 60-2022-1854, datë 08.11.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë, kam vënë në ekzekutim këtë Vendim, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1854, Datë 20.04.2023, kërkesën e kreditorit Shoqëria “PLASTMASI” Sh.a, ndaj debitorit, Shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” Sh.a, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim Nr. 306 (945) Vendimi, të lëshuar me datë 24.04.2019 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, ndryshuar me Vendimin Nr. 60-2022-1854, datë 08.11.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 418 Prot, Datë 20.04.2023 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Vendimi Nr. 306 (945) Vendimi, i lëshuar me datë 24.04.2019 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, ndryshuar me Vendimin Nr. 60-2022-1854, datë 08.11.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori, Shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” Sh.a, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit , dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi sendet e luajtëshme apo të paluajtëshme të debitorit



Person Fizik “ALTIN VAKO”, Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39

Shoqëria "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" Sh.a, në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Për sa më sipër, në referim të Ligjit Nr. 26/2019, Datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet dhe kuotat e:
 - ✓ a. Shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" Sh.a. me Nr. NIPT-i: K72410014H;
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga Shoqëria "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" Sh.a. me Nr. NIPT-i: K72410014H, pranë shoqërive:
 - a. "Furnizuesi i Shërbimit Universal" Sh.a., me Nr. NIPT-i: L81530016L; x
 - b. "Furnizuesi i Tregut të Lirë" Sh.a., me Nr. NIPT-i: L81530029T; ✓
 - c. "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" Sh.a., me Nr. NIPT-i: L81530018E; ✓

Në kushtet kur pala debitore, Shoqëria "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" Sh.a. me Nr. NIPT-i: K72410014H, është zotëruese e aksioneve të këtyre shoqërive, në masën 100%.

2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a. adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b. llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c. bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri.
6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39

